



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Sektori i Rinisë

Prezanton :

Dokumentin për :

POLITIKAT KOMUNALE RINORE

Dokumenti për Politikat Komunale për Rininë e Vushtrisë është një akt i DKRS / Sektori i Rinisë dhe shoqërisë civile për përcaktimin e Politikave Rinore që do të bëjnë të mundur zgjedhjen e shumë problemeve, **plotësimin e nevojave** të të rinjëve.

Objektivë kryesore e këtij projekti të Politikave Rinore është që ky dokument të miratohet në Kuvendin Komunal të Vushtrisë.

Pas miratimit të këtij dokumenti, implementimin e tij do ta bëjë Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Sektori për Rini në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Disa informata për projektin Politikat Komunale Rinore

Projekti Politikat Komunale Rinore është financuar nga Ministria për Kulturë, Rini, Sport dhe Qështje jo Rezidente / Departamenti i Rinisë dhe Kuvendi Komunal i Vushtrisë dhe ka filluar të implementohet në fillim të muajit nëntor 2004 me një pjesëmarrje të të gjithë faktorëve relevant rinor, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe vlen të përsëritet ndihma dhe asistencë e GTZ (Agjensioni për Bashkëpunim teknik nga Gjermania).

Politikat Rinore ???

Në bazë të një anketimi të bërë me 302 të rinjë të Komunës sonë 71.82 % e tyre nuk dinë se çka janë Politikat Rinore, vetëm 25.18% kanë dëgjuar ndonjëherë për këtë fjalë ndërsa rreth 3 % nuk kanë dhënë kurrfarë përgjegje. Politikat Rinore ose fjala politika shumë herë ngatërrohet me fjalën politike, mirëpo që të dyja kanë kuptime të ndryshme.

Kuptimi i këtyre dy fjalëve në gjuhën angleze është i kuptueshëm lehtë policy dhe politics çka d.m.th. se me fjalën politika në kuptojmë : një strategji, plan, rregulla apo një rrugë e cila duhet ndjekur për të arritur deri te synimet tona të planifikuara.

PROGRAMI 1

RRJETI RINOR I VUSHTRISË

Përkufizim :

Rrjeti Rinor i Vushtrisë (në tekstin e mëtejme RrRV) është asociacion joprofitabil, joqeveritar, i pavarur dhe vullnetar. Është bashkim i organizatave, **grupeve jo-formale rinore** dhe qendrave rinore të cilat funksionojnë në Vushtri.

Qëllimi

Funksionon si trup i përbashkët rinor në Vushtri.

Emërtimi i tyre si program

- Ngritje e kapaciteteve – fuqizim i organizimit rinor.
- Partneritet në mes RrRV dhe institucioneve komunale në interes të rinisë.

Formulimi i mënyrave se si të arrihet qëllimi

- Kostituimi i Rrjetit Rinor të Vushtrisë.
- Mbledh dhe ofron informata për aktivitetet e organizatave rinore.
- Shkëmbim i ndërsjellë **i përvojave mes** organizatave rinore.
- Inkurajon të rinjtë që të kyqen në procese të interesit të tyre.
- Vepron si institucion këshillues për institucionet dhe rininë në përgjithësi.
- Udhëheq programe dhe projekte në interes të rinisë.

Formulimi i kriteve

- Anëtar të RrRV mund të jenë të gjitha organizatat dhe qendrat rinore që posedojnë identitet ligjor (sipas rregullorës së UNMIK –ut 1999/22).
- Anëtarësi, përgjegjësi dhe obligimet e anëtarëve rregullohen me statutin e RrRV
- Anëtarë të RrRV mund të jenë edhe grupet joformale të shkollave.
- Anëtarësi i organizatave është vullnetar.
- RrRV nëse ka përbërje multietnike, duhet që në atë frymë të rregulloj edhe përfaqësimin në Bordin udhëheqës.

Planifikimi i aktiviteteve

- Rrjeti Rinor themelohet me qëllim që të krijohet një klimë bashkëpunimi mes akterëve rinorë në Vushtri dhe kështu të forcohet aktiviteti rinor në tërësi duke vepruar në mënyrë më kompakte (edhe sipas programit të RRRK-së)

Marrja e vendimeve nga komuna

- Kuvendi Komunal, DKRS / Sektori i Rinisë e konsideron RrRV si partner në projektet rinore.
- RrRV i mundësohet që një apo dy herë në vit ti drejtohet Kuvendit Komunal në seancat e saj për problemet rinore.
- DKRS / Sektori i Rinisë ka për obligim që me rastin e konstituimit të RrRV të siguroj hapsirë (zyre) për funksionimin e aktiviteteit të saj.
- Kryetari i Kuvendit Komunal do të duhej që RrRV ta konsideroj si trup këshillëdhënës i cili do të ofroj këshilla, propozime dhe ide lidhur me zhvillimin e përgjithëshëm të komunës e në veqanti prezentimin dhe afirmimin e pozitës së të rinjëve.

- Kryetari i Kuvendit Komunal do të duhej që me RrRV dhe akterët tjerë rinorë të caktoj dinamikën e takimeve të rregullta së paku një herë në tre muaj.

PROGRAMI 2

PJESËMARRJA NË VENDIMMARRJE

Përkufizim :

Pjesëmarrje e të rinjëve në procesin e vendimmarrjesë do të thotë të rinjët ftohen (përmes DKRS / Sektorit të Rinisë) dhe mendimi i tyre respektohet në takime konsultative nga strukturat e ndryshme të Kuvendit Komunal, kur këto struktura duhet të marrin një vendim që drejtëpërdrejtë i përket të rinjëve.

Identifikimi i nevojave

Krijimi mundësisë për pjesëmarrje në vendimmarrje i të rinjëve

Vlerësimi i rëndësisë së tyre

- Rinia duke marrë pjesë në proceset e vendimmarrjesë krijon një lidhëshmëri të nevojshme me institucionet komunale.
- Organizatat rinore (sidomos RrRV) kanë nevojë që për qështje të tyre të jenë pjesë e vendimeve.
- Organizatat rinore (sidomos RrRV) mund që drejtëpërdrejt të propozoj dhe dizajnoj projekte të nevojshme për rininë.

Qëllimi

Përfaqësimi i të rinjëve në instancat më të larta lokale qeverisëse.
Realizimi i projekteve efikase për të rinjët nga Kuvendi Komunal.

Emërtimi i tyre si program

Pjesëmarrje aktive në vendimmarrje.

Formulimi i mënyrave se si të arrihet qëllimi

- Konsultimet me të rinjët (me të gjitha organizatat rinore, sidomos RrRV).
- Çdo vendim që merret për dhe rreth të rinjëve, ai duhet ta ketë pëlqimin e të rinjëve.

Formulimi i kriterëve

Organizatat dhe grupet rinore e gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjesë në institucionet kryesore të Kuvendit Komunal.

Planifikimmi i aktiviteteve

- Formimi i Rrjetit Rinor Vushtrrias
- Organizatat rinore (sidomos RrRV) të krijojnë kontaktet e nevojshme me DKRS / Sektorinë e Rinisë dhe organeve tjera kryesore të Kuvendit Komunal.

- Organizatat rinore (sidomos RrRV) marrin pjesë dhe kanë mundësi ti drejtohen Kuvendit Komunal, Komitetit për politikë e financa, Bordit të Drejtorëve për projektet dhe interesat e tyre rinore.
- Organizatat rinore (sidomos RrRV) krijojnë raporte partneriteti me institucionet komunale.

Marrja e vendimeve nga komuna

- Kuvendi Komunal, DKRS / Sektori i Rinisë ju mundësojnë organizatave rinore (sidomos RrRV) që në kuadër të nevojave rinore ata të jenë pjesëmarrës në organet e lartcekura.
- DKRS / Sektori i Rinisë obligohet që organizatave rinore (sidomos RrRV) t'u ofroj informacionet, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e nevojshme me qëllim të qasjes në të gjitha aktivitetet e Kuvendit Komunal që kanë të bëjnë me rininë.

PROGRAMI 3

EDUKIMI JO-FORMAL, EDUKIMI SHËNDETSOR DHE PARANDALIMI

Përkufizim :

Me edukim jo-formal nënkuptojmë aftësimin e të rinjëve për lëmenj specifik, të cilat nuk mund të arrihen nga edukimi formal. Ky edukim do të bëhet nëpërmes metodave trajnuese, në kurse, seminare, ligjërata, tribuna etj.

Identifikimi i nevojave

Zhvillimi i vetëdijesë mes të rinjëve lidhur me përgjegjësitë qytetare (edukimi shëndetësor, parandalimi i sjelljeve devijante dhe të rrezikshme, trajnimet profesionale).

Vlerësimi i rëndësisë së tyre

Në procesin e rregullt edukativo-arsimor ka mungesë/nuk ofrohen njohuri të mjaftueshme në disa fusha jetësore.

Qëllimi

- Ngritja e vetëdijes tek të rinjtë.
- Promovimi i një rinije të shëndoshë.
- Parandalimi i sjelljeve devijante.
- Largimi i të rinjëve nga proceset negative në shoqëri.
- Rritja e aktiviteteve rinore në këtë plan.
- **Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë**

Emërtimi si program

Edukimi joformal (trajnime, punëtori, tribuna etj).

Arritja e qëllimit

- Trajnimi për udhëheqje rinore.
- Fushata ndërgjegjësuere
- Trajnimi i trajnerëve (trajnimi i të rinjëve në mes veti për edukim).

- Trajnimet etj.

Identifikimi/gjetja e indikatorëve

- Qasja e të rinjëve në procese vendimmarrëse.
- Zvoglimi-eliminimi i dukurive negative dhe të dëmshme të rinjët.
- Inicimi dhe realizimi i aktiviteteve të ndryshme nga të rinjët.

Formulimi i kriterëve

- Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria.
- Përfshirja e barabartë e të rinjëve (mosha, gjinia, përkatësia etnike, vendi etj).
- Të jetë në përputhje me interesat dhe prioritetet rinore.

Propozimi i aktiviteteve

- Dizajnimi i planit të punës nga:
 - përfaqësues të DKRS / Sektori i Rinisë.
 - përfaqësues të RrRV.
 - përfaqësues të OJQ-ve.
 - përfaqësues të grupeve jo -formale të shkollave.
- Të përcaktoj buxhetin optimal.
- Të hulumtoj dhe të ndihmoj në sigurimin e burimeve tjera të mundëshme materiale.
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse me Drejtorinë e Arsimit – Drejtorinë e Shëndetësisë – Institucioneve që merren me mbrojtjen e Ambientit, SHPK, TMK, KFOR etj.
- Evaluimi i programeve në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Marrja e vendimeve nga komuna

- Të inicioj dhe të organizoj takimet për dizajnimin dhe realizimin e planit të punës.
- Të ofroj apo të ndihmoj mbështetje financiare për aktivitete.

PROGRAMI 4

INFORMIMI I TË RINJËVE

Përkufizim :

Me informim të të rinjëve kuptojmë ndërrmarjen e aktiviteteve të ndryshme dhe të shumëllojshme të cilat kanë për qëllim kryesor informimin e të rinjëve për fusha të ndryshme në interesin e tyre.

Identifikimi i nevojave

Ka shkëmbim të pamjaftueshëm të informatave në komunën tonë.

Vlersimi i rëndësisë së tyre

Për çfarë informatash ka nevojë rinia Vushtrriase?

- Vendimet e dalura nga Kuvendi Komunal.
- Funksionimi, organizimi dhe struktura e Kuvendit Komunal.

- Mundësia e tyre për t'u kyqur në proceset vedimmarrëse.
- Informim për të drejtat dhe obligimet e tyre që kanë në shoqëri.
- Projektete e Kuvendit Komunal për të Rinjë.
- Buxhetin e Kuvendit Komunal për të rinjë.
- Projekte që kërkojnë punë Vullnetare.
- **Mundësi për punësim**
- Dukurit negative në shoqëri.
- Mundësitë për edukim jo -formal.
- Mundësitë e shkollimit të mesëm dhe të lart.
- Mundësi për bursa dhe shkollim jasht vendit
- Informacionet e publikuara për funksionimin e të gjitha institucioneve dhe organizatave që merren me punën e rinisë.

Rëndësia e informacioneve të tilla për rininë Vushtrriase ?

- Ngritja e nivelit të njohurive për aktivitetet e tyre.
- Ngritja/rritja e informacioneve/njohurive për kapacitetet e akterëve rinorë.
- Mundësi më e madhe për bashkëpunim dhe ide të reja.
-

Formulimi i qëllimeve

Të gjithë të rinjtë në komunën tonë duhet të kenë qasje të lirë në të gjitha informatat e natyrës së përgjithshme dhe në ato të veçanta e që kanë të bëjnë me çështjet rinore, ngjarjet dhe aktivitetet rinore.

Emërtimi i tyre si program

Një shërbim i ri informues për të rinjtë e komunës së Vushtrrisë.

Formulimi i mënyrave se si të arrihet qëllimi

- Tabelat informuese/prezentuese në shkolla.
- Fletushka me informacione aktuale
- Konferenca për shtyp
- Tribuna të hapura në komunë/shkolla, biseda me të rinjtë
- Vitrina (t) në vendet publike.
- Web-faqe për të rinjtë (ose link i posaçëm rinor, në web-faqen ekzistuese).
- Revistë rinore.
- Program rinor në radio lokale.

Identifikimi /gjetja e indikatorëve

Të rinjtë e komunës së Vushtrrisë e njohin dhe e përdorin shërbimin informues që të informojnë për vetveten lidhur me atë çfarë po ndodhë.

Apo : organizatat rinore dhe administrata komunale të përdorin shërbimin e ri informues për të shpërndarë informacionet e veta tek të rinjtë.

Formulimi i kritereve

- Rrjedha e informacioneve do të duhej të arrijë te të rinjët edhe nëpër fshatra.
- Do të duhej të jetë e lirë.
- Do të duhej që të jetë e plotësuar me informatat më të reja dhe interesante.
- Do të duhej të bëhej nga të rinjët për të rinjët.
- Aktivitete që inkurajojnë involvimin e grupeve të marginalizuara .

Propozimi i aktiviteteve

- Do të duhej që të formohej një seksion i të rinjëve, i cili do të merrej me grumbullimin dhe shpërndarjen e informacioneve të ndryshme (në forma të ndryshme si: revista, e-mail, tabela informuese/prezantuese, radio, ngjarje/organizime të ndryshme etj).
- Krijimi i një baze të të dhënave për : akterët e ndryshëm rinor, donatorët dhe posaqërisht për potencialin rinor të komunës.

Marrja e vendimeve nga komuna

- Përgjegjësi i Sektorit për Rini do të mund të krijonte tabelat publike informuese/prezantuese për të rinjët.
- Të bisedonte me drejtorët e shkollave për t'i krijuar dhe vendosur të njëjtat nëpër shkolla.
- Të kërkojë nga zyra e informacionit që në kuadër të web-faqesë të hapet menjëherë një link për rininë.
- Komuna do të duhej mbuloj **shpenzimet bazë për funksionimin e sistemit të informimit rinor** si dhe të publikojë ftesë (konkurse) për projekt-propozime nga organizatat rinore, që të mbështesë në mënyrë financiare disa nga projektet.

PROGRAMI 5

INFRASTRUKTURA RINORE

Identifikimi i nevojave

Mungesa e infrastrukturës rinore dhe mundësive më të mira shoqërore.

Vlerësimi i rëndësisë së tyre

Infrastruktura rinore ka një rëndësi të veçantë sepse është një vend ku të rinjët mund ta shprehin vetveten, kështu që ajo jep kontribut në parandalimin e sjelljeve devijante. Pra Vushtrrisë i nevojitet një Qendër Rinore stabile /e qëndrueshme dhe poashtu edhe objektet tjera kulturore, **rekreative** dhe sportive të cilat duhet të jenë të hapura për rininë.

Qëllimi

Të rinjët në komunën tonë kanë qasje në infrastrukturën rinore adekuate (qendrat rinore, objektet kulturore, sportive etj), ku ata mund të zhvillojnë aftësitë e veta që të shëndrrohen në anëtarë përgjegjës të shoqërisë.

Emërtimi si program

Infrastruktura Rinore e qëndrueshme

Formulimi i mënyrave se si të arrihet qëllimi

- Përshpejtimi i procedurës së projektit të Qendrës Rinore dhe ndërtimi i saj.
- Identifikimi dhe shfrytëzimi i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve rinore.
- Avokim për beneficione në shfrytëzimin e hapësirave kulturore dhe sportive dhe përshtatja e tyre sipas standardeve bashkëkohore.

Identifikimi/gjetja e indikatorëve

- Fillimi i punimeve të Qendrës Rinore.
- Rinia ka qasje në hapësirat kulturore, **rekreative**, sportive dhe shkollore.

Formulimi i kriterëve

- Objekti i Qendrës Rinore duhet të pasqyroj nevojat e të rinjëve.
- RrRV dhe stafi ekzistues i Qendrave Rinore duhet të jenë të involvuara në procesin e planifikimit.
- Të rinjtë të kenë qasje të lirë në shfrytëzimin e hapësirave.

Propozimi i aktiviteteve

- Ndërtimi i Qendrës Rinore.
- Identifikim i hapësirave dhe avokimi për shfrytëzimin e tyre.
- Avokim për renovimin e objekteve ekzistuese për nevojat e rinisë.
- **Përpilimi i projektit ideor.**
- **Organizimi i konferencës me donatorë (sigurimi i fondeve).**
- **Shpallja e tenderit (identifikimi i fituesit potencial të punimeve nga Bordi i përbashkët).**

Marrja e vendimeve nga komuna

- Sektori i Rinisë të formojë grupin konsultativ/punues për ndërtimin e Qendrës Rinore.
- Të ndikojë tek strukturat relevante për shfrytëzimin e hapësirave ku të rinjtë do të zhvillojnë aktivitetet e tyre.

PROGRAMI 6 HULUMTIMET RINORE

- Kuvendi Komunal përmes Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport / Sektorit për Rini, në **bashkëpunim me RRRV** çdo gjashtë muaj realizon një anketë (pyetësor) për të kuptuar dhe mësuar më shumë për gjendjen e të rinjëve në Komunën e Vushtrrisë.
- Rezultatet e këtij kërkimi bëhen publike dhe ju ofrohen institucioneve komunale dhe të gjitha organizatave rinore.
- Rezultatet e kërkimit do të shërbejnë për të drejtuar projektet e ndryshme rinore

PROGRAMI 7 BUXHETI PËR RINI

Organet komunale obligohen të përkrahin në mënyrë financiare punën për rini dhe aktivitetet rinore. Përpos stipendimit të studentëve dhe realizimit të projekteve të caktuara (rindërtimi, zgjerimi dhe përmirësimi i tereneve sportive, ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës, etj) komuna do të duhej të ndaj buxhet të veçant nga ai për kulturë dhe sport me qëllim të implemetimit të dokumentit për Politikën Rinore, aktivitetet, programet dhe projekte të ndryshme rinore.

Qëllimi

- Realizimi i aktivitetet rinore.
- **Rritja në cilësi dhe sasi e ofertës për shërbime rinore.**
- Transparencë në ndarjen e buxhetit për rini.
- Shpallje e konkurseve për projekte rinore së paku një herë në vit.
- **Sigurimi i qëndrueshmërisë afatgjatë të objekteve dhe strukturave rinore (qendrës/eve rinore, RRRV, etj).**

Implementimi

- Kuvendi Komunal me ndarjen e buxhetit vjetor për rini mundëson ndarjen e mjeteve financiare për aktivitetet rinore si dhe dhënjën e granteve për organizatat rinore që funksionojnë në Vushtrri.
- Grantet mund t'i fitojnë organizatat rinore dhe individët të cilat me anë të projekteve të tyre janë në përputhshmëri me Politikën Rinore të Kuvendit Komunal.
- Buxheti për rininë që ndahet në kuadër të buxhetit vjetor të KK-së destinohet për operacionalizime në DKRS /Sektorin për Rini.

PROGRAMI 8 LËVIZSHMËRIA TEK TË RINJËT

Identifikimi i nevojave

Ka mundësi të lëvizshmërisë (mobilitetit) të të rinjëve në komunën e Vushtrrisë .

Vlersimi i rëndësisë së kësaj nevoje

Kush ka nevojë për një lëvizshmëri të rinisë ?

Për mobilitet më të madh kanë nevojë sidomos :

- Të rinjët nga venbanimet rurale.
- Të rinjët nga minoritetet.
- Të rinjët me aftësi të kufizuara.

Sa është kjo e rëndësishme për rininë ?

Stimulimi dhe krijimi i parakushteve për një mobilitet më të madh të rinisë ndikon në:

- Rritjen e numrit të aktivitetet rinore në komunën e Vushtrrisë .
- Shoqërizimin e të rinjëve .
- Integrimin e grupeve të marginalizuara .

- Përfitimin e përvojave të reja .
- **Thyerja e paragjykimeve dhe barrierave**
- **Rritja e nivelit të tolerancës**
-

Formulimi i qëllimeve

Të gjithë të rinjtë e komunës së Vushtrrisë të jenë pjesë aktive dhe të kontribuojnë në zhvillimet e përgjithshme të komunës.

Emërtimi i tyre si program

Integrimet dhe Shkëmbimet Rinore - shërbim i ri që mbështetë një rol më aktiv të të rinjëve në komunën e Vushtrrisë .

Formulimi i mënyrave se si të arrihet qëllimi

- Grupimet (organizimi) i të rinjëve në vendbanimet rurale.
- Aktivitetet e përbashkëta (Muaji Rinor – Dita e Rinisë etj).
- Aktivitetet specifike për integrimin e grupeve të marginalizuara të të rinjëve (femrat , minoritetet , të hendikepuarit etj).
- Krijimi i lehtësirave të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta duke ju mundësuar shfrytëzimin e të gjitha hapsirave egzistuese.
- Vendosja e kontakteve me të rinjtë nga komunat tjera dhe nga rajoni.

Identifikimi

- Të rinjtë e komunës së Vushtrrisë, pa marrë parasysh dallimet (racë ,gjini, përkatësi etnike, aftësi psiko-fizike etj) **bashkëpunojnë në mes vete** dhe me njësinë përkatëse pranë DKRS / Sektorin e Rinisë.
- Shtohet numri i aktiviteteve të përbashkëta dhe i pjesëmarrjes së të rinjëve në rrjedhat e përgjithshme në komunën e Vushtrrisë.
- Shtohet numri i pjesëmarrësve në aktivitetet rinore (masovizimi).

Formulimi i kriterëve

- Grupet e të rinjëve, në vendbanimet rurale, të jenë sa më heterogjene (gjithëpërfshirëse)..
- Aktivitetet e përbashkëta të jenë sa më gjithëpërfshirëse.
- Aktivitetet e propozuara të jenë me kosto sa më të arsyeshme.
- Koordinimi i këtij programi të bëhet nga të rinjtë.

Propozimi i aktiviteteve

DKRS/Sektorin e Rinisë të marrë përsipër :

Organizimin e grupeve rinore në vendbanimet rurale, **stimulimi i vullnetarëve të rinjë** propozimeve/përpilimit të projekteve/aktiviteteve shkëmbyese dhe integruese, vendosja e kontakteve me të rinjtë e komunave dhe rajoneve tjera, vendosja e kontakteve me donatorët potencial etj.

Marrja e vendimeve nga komuna / sygjerime për komunën

- Përgjegjësi i Sektorit për Rini të negocojë me institucione të ndryshme për krijimin e lehtësirave për të rinjtë, dhe për aktivitetet që kanë të bëjnë me këtë program (si: hapësirat për

aktivitete, institucionet e transportit, institucionet kulturore dhe sportive etj). Komuna të shpall **konkurs** për projekt/propozime të ndryshme për integrim dhe shkëmbim rinor, në mënyrë që të mbështetë/përkrah financiarisht ato.

PROGRAMI 9

PËRKRAHJA E AKTIVITETEVE KULTURORE DHE SPORTIVE

Identifikimi i nevojave

Mbështetje më e madhe për aktivitete të kohës së lirë (kulturë, sport, **rekreacion**, ambient etj).

Vlerësimi i rëndësisë së tyre

- Rinia duke u marrë me aktivitete të lira iu shmanget sjelljeve negative dhe **delikuate** (alkoholit, narkomanisë etj).
- Organizatat rinore kanë nevojë për mbështetje në organizimn e aktiviteteve të lira.

Qëllimi

Ti iu ofrohen të rinjëve mundësi të ndryshme për zgjedhjen e aktiviteteve të lira.

Emërtimi i tyre si program

Aktivitete të lira – Rini e shëndoshë.

Formulimi i mënyrave se si të arrihet qëllimi

- Vetëdijësimi i të rinjëve për aktivitete të lira.
- Stimulimi nga institucionet relevante për organizatat dhe grupet që mirren me aktivitete të lira.

Identifikimi/gjetja e indikatorëve

- Rritet numri i aktiviteteve të lira.
- Rritet pjesëmarrja e të rinjëve.
- **Rritet kualiteti i ofertës për aktivitete dhe shërbime rinore gjatë kohës së lirë.**

Formulimi i kriterëve

Organizatrat dhe grupet rinore të gëzojnë benificione në shfrytëzimin e hapësirave kulturore **rekreative** dhe sportive.

Planifikimi i aktiviteteve

- Pastrimi i qytetit.
- Organizimi i manifestimeve të ndryshme kulturore.
- Aktivitete të ndryshme sportive,
- **Organizimi i olimpiadës fshatare.**
- Rregullimi i parqeve.
- Kampingje.
- Punëtori me arte kreative.
- Formimi i Estradës Rinore.
- Organizimi i Ditës së Rinisë.
- Identifikimi i talentëve të rinj në fusha të ndryshme.
- Vendosja e kontakteve me organizatat simotra të vendeve tjera.

Marrja e vendimeve nga komuna

- DRKS / Sektori i Rinisë të inicoj takime me organizatat dhe grupet për dizajnimin e programeve që kanë të bëjnë me ambient, kulturë dhe sport.
- Komuna duhet të ndajë një pjesë të fondit ekzistues OJQ-ve për aktivitete të lira.
- Përgjegjësi i Sektorit për Rini të bëjë evidentimin e talentëve të rinjë.

PËRFUNDIM

DKRS / Sektori i Rinisë në konsultim edhe me organet e Kuvendi Komunal, RrRV, organizatat tjera rinore, sektorët për arsim, kulturë, sport etj. do të formoj një komision i cili duke marr parasysh të kaluarën, të tashmën dhe ë ardhmën e rinisë vushtrriase do të përcaktoj DITËN E RINISË SË VUSHTRRISE.

Për hartimin e Politikave Rinore në Komunën e Vushtrrisë kontribuan përfaqësuesit nga :

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Departamenti i Rinisë (MKRS-QJR) | Prishtinë |
| 2. GTZ | Prishtinë |
| 3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport | Vushtri |
| 4. Drejtoria për Arsim | Vushtri |
| 5. Drejtoria për Shëndetësi | Vushtri |
| 6. Dretoria e Administratës së Përgjithëshme | Vushtri |
| 7. Drejtoria e Sherbive Publike | Vushtri |
| 8. Deputet të Kuvendit Komunal | Vushtri |
| 9. Rinia shkollore Gjinnazi "Eqrem Qabej" | Vushtri |
| 10. Rinia shkollore e SHMT"Lufti Musiqi" | Vushtri |
| 11. Osce (OKIQ) | Mitrovicë - Vushtri |
| 12. Forumi i Rinisë i LDK-së | Vushtri |
| 13. Rinia Demokratike e PDK-së | Vushtri |
| 14. QR "Hareja" | Vushtri |
| 15. QR "YAK" | Vushtri |
| 16. OO "Duga" | Prilluzhë- Vushtri |
| 17. Rinia e Komunitetit Turk | Vushtri |
| 18. QR "Second home" | Vushtri |
| 19. QR "Shtëpia e Shpresës" | Vushtri |
| 20. Omladina Grace | Gracë - Vushtri |
| 21. Handikos | Vushtri |
| 22. Kryqi i kuq | Vushtri |
| 23. OJQ "Orin" | Gjilan |
| 24. OJQ "MiFi" | Vushtri |
| 25. Të rinjë nga lokalitetete larg qytetit | Vushtri |